



PROCESVERBAL 21/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 10 (dhjetë) të rregullt për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 21.10.2022 duke filluar nga ora 09:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga pagesa e shërbimeve mjekësore të “Mamografisë” ;

4.Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Aprovohet pika e 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe fjalën e merr zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës në fshatin Mushtisht, konkretisht për fabrikën e tekstilit që është atje. Fabrika është duke funksionu ka 10 vite, mirëpo i ka kaluar kontrata nga mandatet e kaluara që e ka marrë. Andaj ne sipas ligjit që është në fuqi jemi të obliguar që ti udhëheqim procedurat për dhënie në shfrytëzim. Komisioni ka shpall konkurrimin e hapur dhe është rekomandu ti jepet në shfrytëzim Arta Tex. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga pagesa e shërbimeve mjekësore të “Mamografisë” ;

Kryesuesi - bëhet fjalë për lirimin e të gjitha femrave pa dallim nga pagesa e shërbimeve mjekësore të Mamografi-së.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - a ka afat lirim nga pagesa.

Avni Bytyqi - lirim nga pagesa bëhet për tërë vitin.Deri më tani kanë që të liruara vetëm në muajin tetor.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

4.Të ndryshme;

Kryesuesi - kam pas një kërkesë mbledhjen e kaluar.Qështja ka qenë për zyrën e ZKK-së.Anëtarët e komiteteve pe shohin edhe vet se sa janë të përfaqësuar komitetet,përderisa zyrtari i ZKK-së nuk merr pjesë në takime.Duke pas parasysh kërkesat e komuniteteve në qytet dhe viset rurale ku jetojnë,është pakënaqësi e madhe rreth shërbimeve dhe përgjegjësisë që ka kjo zyre.Unë sot do të jap një rekomandim dhe kërkoj mbështetje edhe prej anëtarëve,drejtuar Kryetarit të Komunës,që asaj zyre ti bëhet e mundur dhe ti shtohet edhe një zyryar sa i përket çështjeve për të drejtat e Komuniteteve.

Aprovohet Rekomandimi

Kryesuesi - kërkon sqarime rreth përgatitjes së rekomandimit drejtuar Kryetarit.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime .

Kryesuesi - qëllimi i këtij rekomandimi është që Kryetari të jetë i informuar dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës të përgatisim një kërkesë edhe në pushtetin lokal.

Takimi përfundoi: 09:15